Buletini Informativ

Prill - Qershor 2026

KLGJ
KËSHILLI I LARTË
GJYQËSOR

10 PRILL 2026

Gjatë kësaj jave, në mjediset e Këshillit të Lartë Gjyqësor, u zhvilluan takimet e radhës të disa prej grupeve të punës që funksionojnë aktualisht brenda Këshillit, në kuadër të përmbushjes së synimeve dhe objektivave strategjike të institucionit.



Në datën 07 prill 2026, në mjediset e Këshillit të Lartë Gjyqësor u mblodh komisioni Ad Hoc për monitorimin e zbatimit të Udhërrëfyesit për Efikasitetin e Pushtetit Gjyqësor në Shqipëri 2025–2027.

Në mbledhje morën pjesë anëtarët e këtij Komisioni, drejtues nga strukturat e Këshillit, këshilltarë, si dhe personel administrativ. Gjatë takimit, u raportua në lidhje me progresin e zbatimit të Udhërrëfyesit për Efikasitetin e Pushtetit Gjyqësor në Shqipëri 2025–2027, si dhe u caktuan detyrat për objektivat që duhen realizuar sipas kalendarit të Udhërrëfyesit.

Gjithashtu, më datë 10 prill 2026, u zhvillua mbledhja e radhës e Grupit Ndërinstitucional të Punës për Hartimin e Propozimeve për Ndryshime Ligjore. Në këtë mbledhje u shqyrtuan propozimet e ardhura që kanë të bëjnë me hartimin e një pakete rekomandimesh për ndryshime ligjore në ligjet nr. 96/2016, “Për Statusin e Gjyqtarëve dhe Prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ligjin 98/2016, “Për Organizimin e Pushtetit Gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ligjin nr.115/2016, “Për Organet e Qeverisjes së Sistemit të Drejtësisë”, i ndryshuar, ligjin nr.49/2012, “Për Gjykatat Administrative dhe Gjykimin e Mosmarrëveshjeve Administrative”, i ndryshuar, si dhe në kodet e procedurës civile dhe penale, të cilat më pas do të përfshihen në një raport përmbledhës.

17 PRILL 2026



Në datat 15-17 prill 2026 në mjediset e Këshillit të Lartë Gjyqësor, u zhvillua workshop-i mbi Standardet dhe Metodologjinë e Procesit të Rivlerësimit, i organizuar nga Operacioni Ndërkombëtar i Monitorimit në të cilin morën pjesë anëtarë të Këshillit të Lartë Gjyqësor, si dhe këshilltarë ligjorë dhe ekonomikë të KLGJ-së dhe KLP-së.

Në fjalën e tij përshëndetëse Kryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, z. Ilir Rusi, falenderoi organizatorët për impenjimin, formatin dhe kohën për zhvillimin e këtij trajnimi, si dhe vlerësoi rëndësinë e thellimit të dijeve në fushën e standardeve dhe metodologjisë në procesin e rivlerësimit.

Workshop-i interaktiv tre ditor përfshiu seksione teorike dhe ushtrime teknike mbi standardet zbatuara gjatë procesit të vetting-ut.

Gjithashtu, u bë edhe një prezantim i përgjithshëm për figurën, me fokus kryesor jurisprudencën më të fundit të GJEDNJ-së, si dhe për strukturën dhe funksionin e analizës financiare gjatë procesit të rivlerësimit.

24 PRILL 2026



Në Këshillin e Lartë Gjyqësor u zhvillua një takim me përfaqësues të Komisionit Evropian, në kuadër të vizitës zyrtare në Shqipëri për çështjet e reformës në drejtësi.

Në takim morën pjesë Kryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, z. Ilir Rusi, Zëvendëskryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, znj. Yllka Rupa, si dhe përfaqësues nga Drejtoria e Përgjithshme për Strategjinë e Zgjerimit dhe Fqinjësinë Lindore në Komisionin Evropian, përkatësisht z. Giulio Venneri, Zëvendësshef i Njësisë për Strategjinë dhe Koordinimin e Zgjerimit, dhe znj. Isabella Torta, Drejtuese e Ekipit për Shqipërinë, si dhe përfaqësues të Delegacionit të Bashkimit Evropian në Tiranë.

Gjatë takimit u diskutuan zhvillimet pas përfundimit të procesit të rivlerësimit kalimtar, ndryshimet më të fundit ligjore në kuadër të paketës së reformës në drejtësi, si dhe ecuria e zbatimit të tyre në praktikë. Në fokus të diskutimeve ishin gjithashtu hapat e mëtejshëm për rritjen e eficiencës së sistemit gjyqësor dhe forcimin e mëtejshëm të institucioneve të drejtësisë.

Pjesëmarrësit theksuan rëndësinë e vijimit të bashkëpunimit të ngushtë ndërinstitucional dhe mbështetjes së vazhdueshme nga Bashkimi Evropian për konsolidimin e reformës në drejtësi në Shqipëri.

Këshilli i Lartë Gjyqësor mbetet i angazhuar për avancimin e reformave dhe garantimin e një sistemi gjyqësor të pavarur, efikas dhe në shërbim të qytetarëve.

27 PRILL 2026



Kryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, z. Ilir Rusi, dhe Ministri i Drejtësisë, z. Toni Gogu, nënshkruan Marrëveshjen e Bashkëpunimit “Për Harmonizimin, Zbatimin dhe Publikimin e të Dhënave Statistikore Kombëtare në Sistemin e Drejtësisë”.

Marrëveshja synon forcimin e bashkëpunimit ndërinstitucional për harmonizimin dhe standardizimin e proceseve të mbledhjes, përpunimit dhe publikimit të statistikave gjyqësore, në përputhje me standardet e Komisionit Evropian për Eficiencën e Drejtësisë (CEPEJ).

Nëpërmjet kësaj marrëveshjeje, palët angazhohen për rritjen e transparencës dhe garantimin e të dhënave statistikore të sakta, të krahasueshme dhe të aksesueshme për publikun.

27 PRILL 2026



Në mjediset e Këshillit të Lartë Gjyqësor u zhvillua mbledhja e radhës e komisionit Ad Hoc për monitorimin e zbatimit të Udhërrëfyesit për Efikasitetin e Pushtetit Gjyqësor në Shqipëri 2025–2027.

Në takim morën pjesë anëtarët e këtij Komisioni, drejtues nga strukturat e Këshillit, këshilltarë, përfaqësues nga projekti JUSTAL, Dhoma Kombëtare e Avokatisë, si dhe personel administrativ i KLGJ-së.

Në këtë mbledhje të Komisionit Ad Hoc, u raportua në lidhje me progresin e zbatimit të Udhërrëfyesit për Efikasitetin e Pushtetit Gjyqësor në Shqipëri 2025–2027, si dhe u caktuan detyrat për objektivat që duhen realizuar sipas kalendarit të Udhërrëfyesit.

Takimi i ardhshëm i Komisionit do të zhvillohet më 12 maj 2026.

28 PRILL 2026



Këshilli i Lartë Gjyqësor, në bashkëpunim me Këshillin e Lartë të Prokurorisë, zhvilloi mbledhjen e parë të përbashkët për vitin 2026.

Kryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, z. Ilir Rusi, në fjalën e tij përshëndetëse theksoi rëndësinë e forcimit të bashkëpunimit ndërinstitucional për rritjen e efikasitetit të sistemit të drejtësisë dhe besimit të publikut.

Në fokus të mbledhjes ishte procesi i vlerësimit etik dhe profesional të magjistratëve, si dhe masat konkrete për uljen e backlog-ut. Diskutimet u përqendruan në sfidat aktuale të procesit të vlerësimit, përfshirë gjendjen ekzistuese, nevojën për koordinim më të ngushtë ndërinstitucional dhe iniciativat ligjore për përmirësimin e mekanizmave të vlerësimit, si sistemi i pikëzimit dhe avancimi në karrierë.

Pjesëmarrësit trajtuan gjithashtu harmonizimin e standardeve ndërmjet dy këshillave, përshpejtimin e procedurave dhe rishikimin e metodologjisë së vlerësimit, me synim thjeshtimin e treguesve, përmirësimin e të dhënave statistikore dhe rritjen e peshës së elementeve cilësore.

Në vijim, u diskutuan masat administrative në mbështetje të procesit të vlerësimit dhe reduktimit të backlog-ut, përfshirë shtimin e burimeve njerëzore, digjitalizimin e dokumentacionit, përdorimin e shortit elektronik dhe forcimin e sistemeve statistikore. Diskutimet e hapura kontribuan në identifikimin e zgjidhjeve konkrete dhe të zbatueshme.

Në përfundim të takimit, u miratuan konkluzionet e përbashkëta dhe u përcaktuan hapat e mëtejshëm për zbatimin e rekomandimeve të dala nga kjo mbledhje.

Këshilli i Lartë Gjyqësor mbetet i angazhuar për garantimin e një sistemi drejtësie transparent, efikas dhe të bazuar në meritë, në shërbim të interesit publik dhe sundimit të ligjit.

30 PRILL 2026

Gjatë kësaj jave, në mjediset e Këshillit të Lartë Gjyqësor u zhvilluan takimet e radhës të disa prej grupeve të punës që funksionojnë në kuadër të përmbushjes së synimeve dhe objektivave strategjike të institucionit.

Më 27 prill 2026 u zhvillua mbledhja e radhës e Grupit Ndërinstitucional të Punës për vlerësimin e masave për sigurinë në sistemin gjyqësor. Në këtë mbledhje u diskutuan masat paraprake që do të ndërmerren, si dhe çështje që lidhen me finalizimin e draftit të planit strategjik për sigurinë në gjykata. Gjithashtu, grupi i punës po vlerëson mundësinë e hartimit të propozimeve për ndryshime ligjore, me fokus forcimin e kuadrit ligjor ekzistues.

Më 30 prill 2026 u zhvillua mbledhja e Grupit të Punës për rishikimin e numrit të përgjithshëm të gjyqtarëve. Gjatë takimit u prezantua dhe u diskutua analiza mbi nevojat për rishikimin e këtij numri, si dhe u përcaktuan hapat që do të ndiqen në vijim.

Gjithashtu, u zhvillua mbledhja e Grupit të Punës për hartimin e një Udhëzuesi për arsyetimin e vendimeve, në përputhje me udhëzimet e CEPEJ mbi cilësinë e debatit gjyqësor dhe thjeshtimin e gjuhës. Gjatë mbledhjes u shqyrtua drafti fillestar i projektit dhe u dakordësua që anëtarët e grupit të punës të paraqesin rekomandimet e tyre, në funksion të vijimit të mëtejshëm të procesit.

Po në datën 30 prill 2026 u zhvillua edhe takimi i Grupit të Punës për hartimin e Udhëzuesit për gjykatat mbi dërgimin e çështjeve në ndërmjetësim. Gjatë këtij takimi, anëtarët e grupit të punës diskutuan në mënyrë të detajuar draftin e përgatitur, duke dhënë komente dhe sugjerime konkrete për përmirësimin e tij.





04 MAJ 2026

Takimi i parë i Komitetit Drejtues të Projektit "Sistemi i Menaxhimit të Çështjeve Gjyqësore, JURONIX" u zhvillua më 4 maj 2026 në ambjentet e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Takimi mblodhi përfaqësues nga institucionet kombëtare, partnerët ndërkombëtarë dhe palët e interesuara të projektit, përfshirë pjesëmarrës nga Delegacioni i BE-së në Shqipëri dhe UNOPS.



Në fjalën e tij hapëse, Kryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, Z. Ilir Rusi, theksoi rëndësinë e forcimit të infrastrukturës IT, garantimit të transparencës së sistemit dhe mbrojtjes së të dhënave, si dhe rritjes së besimit të publikut dhe efikasitetit të përgjithshëm të dhënies së drejtësisë. Ai shprehu gjithashtu mirënjohjen ndaj Qeverisë Suedeze për mbështetjen financiare dhe teknike. Z. Erik Illes, Zëvendës Shef i Misionit në Ambasadën e Suedisë, nënvizoi rëndësinë e sigurimit të ndërveprimit ndërmjet JURONIX dhe bazës së të dhënave e sistemeve të tjera kombëtare, si dhe nevojën për monitorim dhe vlerësim të vazhdueshëm të sistemit.

Gjatë takimit, një prezantim nga stafi i Këshillit të Lartë Gjyqësor ofroi një pasqyrë të sistemit JURONIX, duke përfshirë ecurinë e deritanishme, funksionalitetet kryesore, portalin e përdoruesit dhe proceset vijuese të punës. Vëmendje e veçantë iu kushtua sigurisë së sistemit, mbrojtjes së të dhënave dhe gjurmueshmërisë, ndërsa janë zhvilluar module të dedikuara për adresimin e problematikave dhe gabimeve të konstatuara. U njoftua se së shpejti do të nisë testimi i sistemit me grupe të synuara përdoruesish, me qëllim konfirmimin dhe certifikimin e punës së kryer deri tani dhe vlerësimin e ndërveprimit me sisteme të tjera. Takimi u karakterizua nga diskutime konstruktive, duke kontribuar në zhvillimin e mëtejshëm dhe zbatimin e suksesshëm të sistemit JURONIX.

06 MAJ 2026

Në mjediset e KLGJ-së u zhvillua mbledhja e parë e përbashkët e Komisioneve të Vlerësimit Etiko-Profesional të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë, me pjesëmarrjen e anëtarëve të komisioneve dhe nëpunësve të njësive të vlerësimit të dy këshillave.
Gjatë mbledhjes u diskutua mbi praktikat më të mira në hartimin e raporteve të vlerësimit nga Këshillat, me synim rritjen e cilësisë dhe standardizimit të proceseve të vlerësimit etiko-profesional.

Pjesëmarrësit shkëmbyen mendime dhe përvoja konkrete, duke paraqitur propozime lidhur me elementët e përbashkët si dhe ndryshimet në praktikat e ndjekura nga secili Këshill.

Gjithashtu, diskutimet u fokusuan në forcimin e bashkëpunimit ndërinstitucional dhe në përmirësimin e mëtejshëm të metodologjive të vlerësimit etiko-profesional.

Në përfundim, dy komisionet u angazhuan për vijimin e bashkëpunimit përmes organizimit të mbledhjeve të tjera të përbashkëta, me qëllim rritjen e mëtejshme të standardeve të vlerësimit etiko-profesional.



10 MAJ 2026

Këshilli i Lartë Gjyqësor shpreh angazhimin e palëkundur për garantimin e një sistemi drejtësie të pavarur, transparent dhe në shërbim të qytetarëve.

Kjo ditë lidhet historikisht me dekretimin e Kanunit të Zhurisë nga Qeveria e Ismail Qemalit në vitin 1913, një ndër aktet e para të organizimit të drejtësisë në shtetin shqiptar. Kanuni i Zhurisë përfaqësoi një hap të rëndësishëm në forcimin e parimeve të gjykimit dhe përgjegjësisë publike. Sot, drejtësia mbetet themeli i shtetit të së drejtës, mbrojtjes së të drejtave dhe lirive themelore, si dhe garancia për besimin e publikut tek institucionet.

Në këtë ditë të veçantë, vlerësojmë punën dhe përkushtimin e gjyqtarëve dhe të gjithë profesionistëve të sistemit gjyqësor, të cilët kontribuojnë çdo ditë në forcimin e integritetit, paanshmërisë dhe aksesit në drejtësi.

Këshilli i Lartë Gjyqësor mbetet i përkushtuar në misionin e tij për një drejtësi moderne, efikase dhe të besueshme për çdo qytetar.

11 MAJ 2026

Në kuadër ditës së drejtësisë, Këshilli i Lartë Gjyqësor mori pjesë në përurimin e sallave të reja të gjyqit dhe të mjediseve të tjera të rikonstruktuara në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar. Ky projekt është bashkëfinancuar nga Këshilli i Lartë Gjyqësor dhe Komiteti Ndërinstitucional për Masat kundër Krimit të Organizuar.



Në fjalën përshëndetëse kryetari i KLGJ-së, z. Ilir Rusi nënvizoi faktin se forcimi i kapaciteteve, përmirësimi i infrastrukturës dhe garantimi i kushteve bashkëkohore të punës nuk janë thjesht investime, por ato janë themele në besueshmërinë e sistemit të drejtësisë dhe në të ardhmen Evropiane të Shqipërisë.

Gjithashtu, ai theksoi se reforma në drejtësi ka sjellë sfida të mëdha dhe kërkon ende shumë punë, durim dhe përkushtim, por ajo ka krijuar gjithashtu standarde të reja përgjegjshmërie, integriteti dhe profesionalizmi.

Në vijim z. Rusi tha se Këshilli i Lartë Gjyqësor do të vijojë të jetë i angazhuar për forcimin e pavarësisë, eficiencës dhe modernizimit të sistemit gjyqësor, duke mbështetur çdo iniciativë që kontribuon në rritjen e standardeve të drejtësisë shqiptare.

Në fjalën e tij, titullari i GJKKO-së, z. Erjon Bani, tha se zgjedhja për ta zhvilluar këtë përurim në kuadrin e Ditës së Drejtësisë nuk është rastësore. Ai theksoi se mesazhi kryesor i kësaj dite është i qartë, drejtësia është para së gjithash një shërbim për qytetarin, se procesi ka solemnitet dhe se ligji ka autoritet.

Më tej, Ministri i Drejtësisë, z. Toni Gogu, deklaroi se infrastruktura në gjykatë nuk është çështje periferike e sistemit të drejtësisë, por është pjesë e mënyrës si fuksionon drejtësia çdo ditë. Sipas tij salla e gjyqit nuk është vetëm vendi ku lexohet një vendim, por është ambienti ku shteti duhet të garantojë paanshmëri, siguri, dinjitet procedural dhe autoritetin e ligjit.

Pas fjalimeve përshëndetëse, të pranishmit vizituan mjediset e rikostrukturara të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

12 MAJ 2026

Kryetari i Këshilli i Lartë Gjyqësor, z. Ilir Rusi, mori pjesë në tryezën e diskutimit të organizuar nga Komiteti Shqiptar i Helsinkit mbi temën "Efektet e Reformës së Hartës Gjyqësore në Sistemin e Prokurorisë në Shqipëri", zhvilluar më 12 maj 2026.



Gjatë fjalës së tij, Kryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, z. Ilir Rusi, u ndal në mënyrë të veçantë tek efektet pozitive që ka sjellë zbatimi i hartës së re gjyqësore në sistemin gjyqësor në Shqipëri.

Ai theksoi se reforma ka ndikuar në rritjen e eficiencës së gjykatave, në një organizim më funksional të burimeve njerëzore, si dhe në krijimin e standardeve më të unifikuara në administrimin e drejtësisë.

Z. Rusi evidentoi gjithashtu se, pavarësisht sfidave të hasura gjatë fazës së zbatimit, rezultatet paraprake tregojnë përmirësime të dukshme në menaxhimin e çështjeve gjyqësore dhe në rritjen e cilësisë së shërbimeve ndaj qytetarëve.

Në këtë kuadër, ai shprehu pritshmëri pozitive për të ardhmen e afërt, duke nënvizuar se konsolidimi i mëtejshëm i reformës do të sjellë rritje të aksesit në drejtësi, forcim të eficiencës institucionale dhe ulje graduale të ngarkesës së prapambetur në gjykata.

Kryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor vlerësoi rëndësinë e dialogut institucional dhe të analizave të pavarura mbi reformat në sistemin e drejtësisë, duke theksuar se bashkëpunimi ndërinstitucional mbetet thelbësor për garantimin e një sistemi drejtësie modern, funksional dhe në shërbim të qytetarëve.

13 MAJ 2026

Këshilli i Lartë Gjyqësor mbështetur në nenin 146 të Kodit Zgjedhor, (i ndryshuar), do të organizojë, ditën e martë më datë 19.05.2026, ora 11:00, pranë ambienteve të Këshillit në adresën Rr. "Ana Komnena" godina "Poli i Drejtësisë", hedhjen e shortit për plotësimin e vendit vakant në Kolegjin Zgjedhor Gjyqësor.

Shorti do të jetë i hapur dhe në prani të mediave dhe publikut, përfaqësuesve të KQZ-së, partive politike dhe Organizatave jo-Fitimprurëse, me veprimtari në fushën e zgjedhjeve dhe të drejtësisë.

14 MAJ 2026



Sot më datë 14 maj 2026 u zhvillua takimi i radhës i Mbledhjes së Kryetarëve të Gjykatave, ku u trajtuan çështje me rëndësi për funksionimin e sistemit gjyqësor.

Mbledhja u drejtua nga Zëvendëskryetarja e Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm znj. Iliba Bezati. Në të morën pjesë Zëvendëskryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, znj. Yllka Rupa, anëtarët e Këshillit, znj. Emona Muçi, znj. Irena Plaku, z. Markelian Koça, si dhe drejtuesit e gjykatave të të gjitha niveleve dhe juridiksioneve.

Diskutimet adresuan temën e eficiencës, problematikat e evidentuara nga analizat vjetore, si dhe rolin e lidershipit

gjyqësor në rritjen e performancës. Gjithashtu temat e diskutuara përfshinë infrastrukturën gjyqësore dhe burimet njerëzore, me fokus tek fuqizimi i kapaciteteve profesionale.

Nga të pranishmit u diskutua gjithashtu edhe tema e rëndësishme e sigurisë në gjykata, si aspekt thelbësor për mbarëvajtjen e punës, çështje kjo e cila do të trajtohet në mënyrë më të detajuar në mbledhjen e ardhshme, duke u dhënë hapësirën e nevojshme për diskutim të thelluar dhe për nxjerrjen e rekomandimeve konkrete.

Mbledhja e Kryetarëve të Gjykatave, përfaqëson një mekanizëm të institucionalizuar bashkëpunimi ndërmjet Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe drejtuesve të gjykatave, me synim ndërtimin e një platforme të rregullt diskutimi mbi administrimin gjyqësor, harmonizimin e praktikave dhe adresimin e sfidave konkrete të sistemit.

15 MAJ 2026

Në funksion të përmbushjes së synimeve dhe objektivave strategjikë të Këshillit të Lartë Gjyqësor, gjatë kësaj jave në mjediset e institucionit u zhvilluan takimet e radhës të disa prej grupeve të punës që funksionojnë aktualisht brenda Këshillit.



Në datën 11 maj 2026 u zhvillua mbledhja e rradhës e grupit të punës "Për Hartimin e Udhëzuesit për Gjykatat për Dërgimin e Çështjeve për Ndërmjetësim". Në këtë mbledhje përfundoi hartimi i draftit të Udhëzuesit, ndërkohë që do të vijohet me përgatitjen e formateve standarde që do të shoqërojnë aktin.

Gjithashtu, më datë 12 maj 2026, u zhvillua mbledhja e radhës Komisionit Ad Hoc për monitorimin e zbatimit të Udhërrëfyesit për Efikasitetin e Pushtetit Gjyqësor në Shqipëri 2025–2027.
Gjatë takimit të Komisionit Ad Hoc u raportua në lidhje me progresin e zbatimit të Udhërrëfyesit për Efikasitetin e Pushtetit Gjyqësor në Shqipëri 2025–2027, si dhe u caktuan detyrat për objektivat që duhen përmbushur në përputhje me afatet e Udhërrëfyesit.

18 MAJ 2026

Kryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, z. Ilir Rusi, mori pjesë prezantimin e gjetjeve të Anketës Rajonale të Drejtësisë 2025, në kuadër të misionit të Bankës Botërore për projektin e financuar nga BE-ja “EU4 Rule of Law”.



Në këtë aktivitet merrin pjesë përfaqësues të institucioneve publike, diplomatë, profesionistë të ligjit, përfaqësues të shoqërisë civile, rretheve akademike dhe medias.

Në fjalën e tij, z, Rusi, tha se gjetjet e Anketës së Drejtësisë 2025 tregojnë përmirësime të ndjeshme në perceptimin mbi efikasitetin, cilësinë dhe pavarësinë e sistemit gjyqësor krahasuar me vitin 2020, duke reflektuar rezultatet e reformave të ndërmarra ndër vite.

Gjithashtu, z. Rusi, theksoi rëndësinë e përdorimit të gjetjeve dhe perceptimeve të qytetarëve për forcimin e reformës në drejtësi. Në vijim ai tha se faza e ardhshme e reformës duhet të fokusohet në përmirësimin e menaxhimit gjyqësor, rritjen e cilësisë së vendimmarrjes dhe forcimin e besimit të publikut përmes transparencës dhe integritetit institucional.
Në përfundim, z. Rusi, nënvizoi se Këshilli i Lartë Gjyqësor mbetet i angazhuar që të mbështesë çdo hap të reformës gjyqësore me politika të qëndrueshme për integritet, profesionalizëm dhe efikasitet.

18 MAJ 2026

Kryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, z. Ilir Rusi, dhe anëtari i Këshillit z. Markelian Koça, morën pjesë në mbledhjen e 8-të të Komitetit Drejtues (8th Steering Committee Meeting), organizuar në kuadër të asistencës së projektit JUSTAL për implementimin e Strategjisë Ndërsektoriale të Drejtësisë (SND).

Në fokus të diskutimeve ishte koordinimi ndërinstitucional dhe angazhimi i institucioneve të sistemit të drejtësisë për përmbushjen e prioriteteve të përcaktuara në kuadër të Strategjisë Ndërsektoriale të Drejtësisë, me synim forcimin e efikasitetit, transparencës dhe funksionimit të sistemit të drejtësisë.



Gjatë takimit u prezantua plani i punës i projektit JUSTAL, si dhe u trajtuan objektivat e përcaktuara për periudhën prill – nëntor 2026. Gjithashtu në këtë mbledhje u diskutua mbi detyrat dhe përgjegjësitë për secilin institucion të përfshirë në procesin e zbatimit të strategjisë.

Në fjalën e tij, z. Rusi, theksoi nevojën që planet e punës të institucioneve të jenë të bashkërenduara, si dhe riafirmoi angazhimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor për bashkëpunim të vazhdueshëm institucional dhe përmbushjen e objektivave në kuadër të reformave të konsolidimit të sistemit gjyqësor gjatë të proceseve të integrimit në Bashkimin Europian.

19 MAJ 2026

Këshilli i Lartë Gjyqësor, më datë 19.05.2026 mbështetur në nenin 146 të ligjit nr. 10 019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, organizoi shortin për plotësimin e një vendi vakant në Kolegjin Zgjedhor Gjyqësor.

Në përfundim të procedurës së hedhjes së shortit publik, u përzgjodh si anëtar i Kolegjit Zgjedhor Gjyqësor, znj. Mariana Shegani, gjyqtare pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

Në zbatim të detyrimeve ligjore, Këshilli i Lartë Gjyqësor, do të kryejë procedurat për miratimin në mbledhje plenare të zgjedhjes së anëtarit në vendin vakant të Kolegjit Zgjedhor Gjyqësor, për të vijuar më pas me organizimin e ceremonisë së hapur të betimit të anëtarit të ri të Kolegjit Zgjedhor Gjyqësor.

20 MAJ 2026

Kryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, z. Ilir Rusi, mori pjesë në takimin me studentët e Fakultetit të Drejtësisë të Universitetit të Tiranës, organizuar në kuadër të aktiviteteve “Ditët e Hapura”, që Institucioni i Kontrollit të Lartë të Shtetit zhvilloi me rastin e përvjetorit të themelimit të tij.

Në aktivitetin e drejtuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit, z. Arben Shehu, mori pjesë gjithashtu edhe Dekania e Fakultetit të Drejtësisë, znj. Dorina Hoxha.



Gjatë bashkëbisedimit me studentët, diskutimet u fokusuan në rrugëtimin institucional, përgjegjësitë dhe misionin që Kontrolli i Lartë i Shtetit ka ushtruar ndër vite në shërbim të interesit publik, ligjshmërisë, transparencës dhe forcimit të llogaridhënies në administrimin e financave publike.

Kryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, z. Ilir Rusi, ndau me studentët vlerësime mbi rëndësinë e një sistemi drejtësie të pavarur, profesional dhe transparent, duke theksuar se përfshirja e të rinjve dhe formimi i tyre profesional përbëjnë një investim të domosdoshëm për të ardhmen e institucioneve të drejtësisë dhe forcimin e besimit të publikut tek ato.
Z. Rusi dhe z. Shehu iu përgjigjën interesimit të studentëve lidhur me veprimtarinë institucionale, sfidat profesionale, si dhe mundësitë që institucionet ofrojnë për praktika profesionale dhe punësim pas diplomimit.

Në përfundim të aktivitetit, u vlerësua rëndësia e dialogut të vazhdueshëm ndërmjet institucioneve publike, sistemit të drejtësisë dhe botës akademike, në funksion të forcimit të shtetit të së drejtës dhe promovimit të standardeve më të larta të integritetit dhe profesionalizmit.

22 MAJ 2026

Në datat 21–22 maj 2026, në qytetin e Beratit u zhvillua workshop-i dy ditor me temë "Metodat dhe mjetet e CEPEJ për të adresuar ngarkesën e çështjeve të prapambetura", oganizuar dhe financuar nga Bashkimi Europian dhe Këshilli i Europës, në kuadër të Udhërrëfyesit për Efikasitetin e Pushtetit Gjyqësor në Shqipëri 2025–2027.

Në këtë aktivitet mori pjesë edhe Këshilli i Lartë Gjyqësor përfaqësuar nga Zëvendëskryetarja e Këshillit, znj. Yllka Rupa, anëtarët e Këshillit, z. Markelian Koça, znj. Emona Muçi, znj.Irena Plaku, znj. Gentiana Muçaj, znj. Violanda Theodhori dhe z. Bledar Bajri. Gjithashtu në workshop merrnin pjesë Zëvendësministri i Drejtësisë, z. Tedi Dobi, gjyqtarë të gjykatave të juridiksionit të përgjithshëm dhe atij administrativ, staf adminstrativ i KLGJ-së, si dhe ekspertë ndërkombëtarë të CEPEJ.



Gjatë sesioneve të këtij workshopi u trajtuan tema si: analiza e faktorëve që ndikojnë në krijimin e çështjeve të prapambetura, përdorimi i të dhënave gjyqësore dhe indikatorëve të efikasitetit, masat organizative, operacionale dhe dixhitale për reduktimin e backlog-ut, praktika të suksesshme europiane, si dhe u diskutuan raste konkrete mbi menaxhimin e çështjeve të pronësisë që përfshijnë vlerësime financiare.

Në vijim nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, u bë një prezantim i shkurtër i projektit të Sistemit të Ri të Menaxhimit të Çështjeve, JURONIX, një platformë e avancuar digjitale që synon modernizimin e administrimit të sistemit gjyqësor në Shqipëri.

23 MAJ 2026

Gjatë kësaj jave, në mjediset e Këshillit të Lartë Gjyqësor u zhvilluan takimet e radhës të disa prej grupeve të punës që funksionojnë në kuadër të përmbushjes së synimeve dhe objektivave strategjike të institucionit.



Në datën 19 maj 2026, u zhvillua mbledhja e radhës e grupit të punës Për Hartimin e Udhëzuesit për Gjykatat për Dërgimin e Çështjeve për Ndërmjetësim. Në këtë mbledhje u diskutua dhe u dakordësua mbi anekset që do të shoqërojnë draftin e Udhëzuesit, i cili do i dergohet më pas trupës gjyqësore për të dhënë opinionet dhe sugjerimet e tyre.

Në datën 21 maj 2026, u mblodh grupi i punës Për Rishikimin e Numrit të Përgjithshëm të Gjyqtarëve. Në këtë mbledhje u diskutua mbi shkaqet që kanë ndikuar në krijimin e backlog-ut, si dhe u vlerësua se situata përbën një problematikë që kërkon ndërhyrje dhe zgjidhje konkrete nga KLGJ, nëpërmjet krijimit të mekanizmave të rinj, ose përdorimit më efikas të mekanizmave ekzistues.

29 MAJ 2026

Në datat 28-29 maj, në Shkodër, u mblodh Komisioni Ad Hoc për monitorimin e zbatimit të Udhërrëfyesit për Efikasitetin e Pushtetit Gjyqësor në Shqipëri 2025–2027.

Takimi dy ditor u drejtua nga kryetari i komisionit Ad Hoc, z. Markelian Koça, dhe në të morën pjesë zëvendëskryetarja Këshillit, znj. Yllka Rupa, anëtarët e KLGJ-së, z. Ridvan Hado, znj. Irena Plaku, z. Bledar Bajri, drejtues nga strukturat e Këshillit, këshilltarë, si dhe personel administrativ.

Qëllimi i këtij aktiviteti ishte vlerësimi i progresit të deritanishëm në zbatimin e objektivave strategjike të Udhërrëfyesit, si dhe diskutimi i nevojave për ndryshime ligjore dhe administrative në funksion të mirë fuksionimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe sistemit gjyqësor.



Anëtarët e Komisionit Ad Hoc, diskutuan në sesione të ndryshme mbi ecurinë e zbatimit të këtij dokumenti, përmbushjen e objektivave me afat 6-mujorin e parë të 2026, duke evidentuar progresin e arritur, sfidat e hasura dhe çështjet që kërkojnë ndërhyrje prioritare.

Në përfundim Komisioni Ad Hoc përcaktoi hapat e mëtejshëm institucionalë, përgjegjësitë përkatëse dhe masat prioritare për periudhën në vijim, në funksion të zbatimit efektiv të Udhërrëfyesit dhe përmbushjes së angazhimeve që rrjedhin nga proceset e monitorimit dhe raportimit institucional.

03 QERSHOR 2026

Këshilli i Lartë Gjyqësor zhvilloi një vizitë studimore në Këshillin Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut, në Gjykatën Themelore Penale të Shkupit, në Gjykatën Supreme të RMV, si dhe në Akademinë për Gjyqtarë dhe Prokurorë. Vizita studimore kishte si qëllim shkëmbimin e përvojave dhe praktikave më të mira mes autoriteteve gjyqësore shqiptare dhe atyre të Republikës së Maqedonisë së Veriut.



Në nisje të vizitës në Këshillin Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut, delegacioni shqiptar u prit nga Kryetari, z. Aleksandar Kambovski, me të cilin u diskutua mbi funksionimin e këshillave gjyqësorë, proceset e vlerësimit të gjyqtarëve, sfidat aktuale të administrimit gjyqësor, si dhe pavarësine e sistemit gjyqësor.

Vizita e Këshillit të Lartë Gjyqësor vijoi në Gjykatën Themelore Penale të Shkupit, ku delegacioni u prit nga Kryetarja e Gjykatës, znj. Daniella Dimovska. Gjatë takimit u shkëmbyen përvoja mbi organizimin e kësaj gjykate dhe menaxhimin e çështjeve gjyqësore.

Në Gjykatën Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, delegacioni shqiptar u prit nga Kryetari, z. Afrim Fidani. Në këtë takim u diskutua mbi rolin e gjykatës më të lartë në garantimin e një jurisprudence të unifikuar.

Gjithashtu, delegacioni i KLGJ-së zhvilloi një vizitë në Akademinë për Gjyqtarë dhe Prokurorë të Republikës së Maqedonisë së Veriut, ku u prit nga drejtuesja, znj. Irina Trajkoska Strezovska. Diskutimet në takim fokusuan në formimin fillestar dhe vazhdues të magjistratëve.

Në kuadër të procesit të integrimit evropian, Këshilli i Lartë Gjyqësor i kushton rëndësi të veçantë shkëmbimit të eksperiencës me institucionet homologe, me synimin për të rritur kapacitetet e menaxhimit të sistemit gjyqësor.

5 QERSHOR 2026

Në funksion të realizimit të objektivave strategjike të Këshillit të Lartë Gjyqësor, në datën 5 qershor 2026, në mjediset e institucionit u zhvillua mbledhja e radhës e grupit të punës Për Hartimin e Udhëzuesit për Gjykatat për Dërgimin e Çështjeve për Ndërmjetësim.

Në këtë mbledhje u morën në shqyrtim propozimet dhe komentet e përcjella nga trupa gjyqësore në lidhje me projekt-udhëzimin e përgatitur nga grupi i punës dhe në përfundim të diskutimeve u vendos që drafti t'i përcillet për shqyrtim mbledhjes plenare të Këshillit

Në këtë mbledhje u morën në shqyrtim propozimet dhe komentet e përcjella nga trupa gjyqësore në lidhje me projekt-udhëzimin e përgatitur nga grupi i punës dhe në përfundim të diskutimeve u vendos që drafti t'i përcillet për shqyrtim mbledhjes plenare të Këshillit.

Grupi i punës Për Hartimin e Udhëzuesit për Gjykatat për Dërgimin e Çështjeve për Ndërmjetësim, është ngritur në kuadër të Udhërrëfyesit për Efikasitetin e Pushtetit Gjyqësor në Shqipëri 2025–2027 dhe synon të kontribuojë në forcimin e mekanizmave të zgjidhjes alternative të mosmarrëveshjeve, si dhe në rritjen e efikasitetit të sistemit gjyqësor.



10 QERSHOR 2026

Sot, më datë 10 qershor 2026, në mjediset e Këshillit të Lartë Gjyqësor u zhvillua takimi ndërinstitucional në kuadër të çështjes së sigurisë në gjykata.

Në këtë takim morën pjesë deputetë të Komisionit për Nismat Qytetare, Bashkëpunimin dhe Mbikëqyrjen Institucionale, anëtarë të KLGJ-së, anëtarë të KLP-së, përfaqësues të Prokurorisë së Përgjithshme, Ministrisë së Drejtësisë, drejtues të gjykatave dhe drejtues të prokurorive.

Gjatë diskutimeve u trajtuan problematikat kryesore që lidhen me garantimin e sigurisë në institucionet e drejtësisë, si dhe nevoja për një qasje të unifikuar dhe afatgjatë në këtë drejtim.



Në këtë kuadër, u theksua rëndësia e përmirësimit të kuadrit rregullator për sigurinë në gjykata, si dhe nevoja për standardizimin e praktikave dhe procedurave të sigurisë në të gjitha nivelet e sistemit gjyqësor dhe prokurorial. Po ashtu, u nënvizua domosdoshmëria e përmirësimit të infrastrukturës së godinave gjyqësore, me qëllim garantimin e kushteve të përshtatshme të sigurisë për gjyqtarët, stafin administrativ dhe publikun.

Një tjetër çështje e evidentuar ishte forcimi i kapaciteteve njerëzore dhe rritja e efektivitetit të shërbimeve të sigurisë në gjykata, si element thelbësor për funksionimin normal dhe të sigurt të institucioneve të drejtësisë.
Në përfundim të takimit, u vlerësua nevoja për forcimin e koordinimit ndërinstitucional dhe bashkëpunimit të qëndrueshëm ndërmjet të gjitha institucioneve përgjegjëse, me qëllim adresimin në mënyrë më efektive të sfidave që lidhen me sigurinë në gjykata dhe avancimin e mëtejshëm të standardeve të sigurisë në sistemin e drejtësisë.

10 QERSHOR 2026



Në takim morën pjesë z. Ilir Rusi, Kryetar i Këshillit të Lartë Gjyqësor, z. Klodian Kurushi, Anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor, dhe znj. Irena Plaku, Anëtare e Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Nga ana e Komisionit Evropian morën pjesë znj. Valentina Superti, Drejtoreshë për Ballkanin Perëndimor në Drejtorinë e Përgjithshme për Zgjerimin dhe Fqinjësinë Lindore (DG ENEST), znj. Isabella Torta, Drejtuese Ekipi në Sektorin e Sundimit të Ligjit në DG ENEST, znj. Charlotte Garyga, Zyrtare për Politikat në DG ENEST, si dhe përfaqësues të Delegacionit të Bashkimit Evropian në Tiranë.

Gjatë takimit u diskutuan çështje me rëndësi për procesin e reformës në drejtësi dhe avancimin e mëtejshëm të standardeve të sistemit gjyqësor.

Në fokus të diskutimeve ishte përmbushja e objektivave të reformës në drejtësi, hapat e mëtejshëm për rritjen e efikasitetit të sistemit gjyqësor dhe forcimin e institucioneve të drejtësisë.
Palët trajtuan çështje që lidhen me uljen e stokut të çështjeve gjyqësore, plotësimin e vakancave në sistemin gjyqësor, si dhe zhvillimin e mëtejshëm të Sistemit të Menaxhimit të Çështjeve, si elemente të rëndësishme për rritjen e efikasitetit dhe cilësisë së administrimit të drejtësisë.

Palët vlerësuan bashkëpunimin e deritanishëm dhe riafirmuan angazhimin për vijimin e dialogut konstruktiv dhe mbështetjen e proceseve reformuese në sistemin gjyqësor shqiptar, në përputhje me standardet evropiane dhe objektivat e integrimit të vendit në Bashkimin Evropian.

Këshilli i Lartë Gjyqësor mbetet i angazhuar për avancimin e reformave dhe garantimin e një sistemi gjyqësor të pavarur, efikas dhe në shërbim të qytetarëve.

12 QERSHOR 2026

Në kuadër të përmbushjes së objektivave strategjike të Këshillit të Lartë Gjyqësor, më 12 qershor 2026, në mjediset e institucionit, u zhvillua mbledhja e radhës e grupit të punës për hartimin e një Udhëzuesi për Arsyetimin e Vendimeve në Përputhje me Udhëzimet e CEPEJ-it mbi Cilësinë e Debatit Gjyqësor dhe Thjeshtimin e Gjuhës.

Në këtë mbledhje u morën në shqyrtim rekomandimet e përgatitura nga anëtarët e këtij grupi pune, të cilat më pas do të përdoren për krijimin e modeleve orientuese dhe të strukturave standarde që synojnë thjeshtimin e gjuhës së përdorur në vendimet gjyqësore.



Grupi i punës për hartimin e një Udhëzuesi për Arsyetimin e Vendimeve në Përputhje me Udhëzimet e CEPEJ-it mbi Cilësinë e Debatit Gjyqësor dhe Thjeshtimin e Gjuhës është ngritur me qëllim identifikimin dhe promovimin e praktikave më të mira në arsyetimin e vendimeve gjyqësore, duke synuar përdorimin e një gjuhe më të qartë, më të kuptueshme dhe më të aksesueshme për qytetarët.

12 QERSHOR 2026

Sot më 12 qershor 2026, Kryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, z. Ilir Rusi, mori pjesë në ceremoninë zyrtare të nisjes së projektit rajonal "Fuqizimi i Sistemeve të Ndërmjetësimit në Evropën Juglindore" (SEE Mediation), një nismë e rëndësishme që synon forcimin e sistemeve të ndërmjetësimit dhe promovimin e zgjidhjes alternative të mosmarrëveshjeve në Shqipëri, Kosovë dhe Maqedoninë e Veriut.



Në këtë aktivitet morën pjesë përfaqësues të institucioneve të drejtësisë, organizatave ndërkombëtare, komunitetit të ndërmjetësuesve dhe partnerëve të projektit nga vendet e rajonit.

Gjatë fjalës së mbajtur në këtë ceremoni, Kryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, z. Rusi, theksoi rëndësinë e ndërmjetësimit si një instrument thelbësor për modernizimin e sistemit të drejtësisë dhe rritjen e aksesit të qytetarëve në zgjidhje më të shpejta, më efikase dhe më pak konfliktuale të mosmarrëveshjeve.

Kryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, nënvizoi gjithashtu se Shqipëria ka bërë hapa të rëndësishëm drejt institucionalizimit të ndërmjetësimit brenda sistemit gjyqësor, megjithëse procesi kërkon ende investime të mëtejshme në kapacitete profesionale, mbështetje institucionale dhe bashkëpunim të vazhdueshëm ndërmjet aktorëve të përfshirë.
Në këtë kuadër, projekti SEE Mediation u vlerësua si një mundësi e rëndësishme për shkëmbimin e praktikave më të mira rajonale, ngritjen e kapaciteteve profesionale dhe harmonizimin e standardeve të ndërmjetësimit në rajon, duke kontribuar njëkohësisht në proceset e integrimit evropian të vendeve pjesëmarrëse.

Në përfundim, z. Rusi, riafirmoi gatishmërinë e Këshillit të Lartë Gjyqësor për të vijuar bashkëpunimin me partnerët kombëtarë dhe ndërkombëtarë në funksion të modernizimit të sistemit gjyqësor, forcimit të ndërmjetësimit dhe rritjes së besimit të qytetarëve te drejtësia.

17 QERSHOR 2026



Kryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, z. Ilir Rusi, mori pjesë sot në ceremoninë përmbyllëse të procesit të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve, organizuar nga Kolegji i Posaçëm i Apelimit në Tiranë.

Në panelin kushtuar rolit dhe rëndësisë së institucioneve kushtetuese në vazhdimësinë e standardeve të procesit, Kryetari Rusi vlerësoi procesin e rivlerësimit kalimtar si një nga reformat më të rëndësishme dhe transformuese të sistemit të drejtësisë në Shqipëri, duke theksuar se ky proces ka kontribuar në forcimin e integritetit të sistemit gjyqësor, rritjen e transparencës dhe llogaridhënies, si dhe në konsolidimin e besimit të publikut te drejtësia.

Gjatë fjalës së tij, z. Rusi shprehu mirënjohjen për institucionet që kanë luajtur rol kyç në realizimin e këtij procesi, përfshirë Kolegjin e Posaçëm të Apelimit, Komisionin e Pavarur të Kualifikimit, Komisionerët Publikë, Operacionin Ndërkombëtar të Monitorimit, si dhe partnerët ndërkombëtarë që kanë mbështetur reformën në drejtësi dhe rrugëtimin evropian të Shqipërisë.

Kryetari i KLGJ-së theksoi se përmbyllja e procesit të rivlerësimit nuk përbën fundin e reformimit të sistemit të drejtësisë, por një moment reflektimi dhe një pikënisje të re për forcimin e mëtejshëm të standardeve të pavarësisë, profesionalizmit dhe efikasitetit të gjyqësorit.

Në këtë kuadër, ai nënvizoi angazhimin e vazhdueshëm të Këshillit të Lartë Gjyqësor për të çuar përpara proceset e reformimit të brendshëm të sistemit gjyqësor, për të forcuar kapacitetet profesionale të gjyqtarëve dhe për të garantuar një administrim sa më efikas, transparent dhe në shërbim të qytetarëve.

Gjithashtu, z. Rusi vuri në dukje rëndësinë e bashkëpunimit institucional ndërmjet organeve të sistemit të drejtësisë, duke e konsideruar atë një element thelbësor për garantimin e stabilitetit institucional dhe forcimin e mëtejshëm të besimit të qytetarëve te drejtësia.

Në përfundim, Kryetari i KLGJ-së theksoi se procesi i rivlerësimit kalimtar mbetet një dëshmi e angazhimit të përbashkët të institucioneve shqiptare për ndërtimin e një sistemi drejtësie të besueshëm, të pavarur dhe në përputhje me standardet evropiane.

17 QERSHOR 2026

Kryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, z. Ilir Rusi, prezantoi në Komisionin për Çështjet Ligjore dhe Administratën Publike, Raportin mbi Gjendjen e Sistemit Gjyqësor dhe Veprimtarinë e Këshillit të Lartë Gjyqësor për vitin 2025.

Në këtë seancë dëgjimore, Kryetari i KLGJ-së u shoqërua nga anëtarët e Këshillit të Lartë Gjyqësor znj. Irena Plaku dhe z. Albens Tabaku.
Gjatë prezantimit të raportit, z. Rusi paraqiti një panoramë të plotë të veprimtarisë së Këshillit gjatë vitit 2025, duke nënvizuar zhvillimet kryesore, rezultatet e arritura në funksion të forcimit të pavarësisë, efikasitetit dhe transparencës së sistemit gjyqësor, si dhe sfidat që vijojnë të kërkojnë vëmendje institucionale.

Kryetari i KLGJ-së theksoi se, pavarësisht progresit të shënuar në konsolidimin e reformave dhe përmirësimin e treguesve të performancës së sistemit gjyqësor, mbeten ende sfida të rëndësishme që lidhen me nivelin e vakancave në gjykata, raportin gjyqtar/popullsi, menaxhimin e çështjeve të prapambetura dhe kohëzgjatjen e proceseve gjyqësore. Në këtë drejtim, ai nënvizoi se adresimi i këtyre sfidave kërkon vazhdimësinë e angazhimeve institucionale dhe zbatimin e masave të qëndrueshme e afatgjata.



Në vijim, z. Rusi prezantoi prioritetet strategjike të KLGJ-së për periudhën 2026–2028, të cilat përqendrohen në plotësimin progresiv të vakancave në sistemin gjyqësor, avancimin e transformimit digjital të gjykatave, forcimin e mekanizmave për reduktimin e backlog-ut, si dhe rritjen e kapaciteteve institucionale, administrative dhe teknologjike të Këshillit dhe të sistemit gjyqësor në tërësi.

Gjatë seancës dëgjimore, Kryetari i KLGJ-së iu përgjigj interesimit dhe pyetjeve të deputetëve, duke ofruar sqarime mbi çështje që lidhen me funksionimin e sistemit gjyqësor, ecurinë e reformave dhe objektivat e Këshillit për periudhën në vijim.

Këshilli i Lartë Gjyqësor mbetet i angazhuar për të vijuar përpjekjet në funksion të garantimit të një sistemi gjyqësor të pavarur, profesional, efikas dhe të aksesueshëm për qytetarët.

18 QERSHOR 2026

Gjatë kësaj jave, në mjediset e Këshillit të Lartë Gjyqësor, u zhvilluan takimet e radhës të disa prej grupeve të punës që funksionojnë në kuadër të përmbushjes së synimeve dhe objektivave strategjike të institucionit.



Në datën 17 qershor 2026, u zhvillua mbledhja e radhës e Komisionit Ad Hoc për monitorimin e zbatimit të Udhërrëfyesit për Efikasitetin e Pushtetit Gjyqësor në Shqipëri 2025–2027. Në këtë mbledhje u raportua në lidhje me progresin e zbatimit të Udhërrëfyesit për Efikasitetin e Pushtetit Gjyqësor në Shqipëri 2025–2027, si dhe u caktuan detyrat për objektivat që duhen përmbushur në përputhje me afatet e Udhërrëfyesit.

Gjithashtu, në datën 17 qershor 2026, u zhvillua mbledhja e grupit të punës për hartimin e Udhëzuesit për gjykatat për dërgimin e çështjeve për ndërmjetësim. Gjatë takimit u vlerësua miratimi i Udhëzimit “Për referimin e ndërmjetësimit nga gjykata”, si dhe u diskutuan hapat e mëtejshëm për zbatimin e këtij udhëzimi, me qëllim nxitjen e përdorimit të mekanizmit të ndërmjetësimit për uljen e ngarkesës së gjykatave dhe rritjen e efikasitetit të sistemit gjyqësor.

Në datën 18 qershor 2026, u mblodh grupi i punës për Hartimin e Rregullave të Eficiencës për Gjykatat. Gjatë mbledhjes u diskutua mbi draftin “Për menaxhimin, monitorimin dhe kontrollin e kohëzgjatjes së pezullimit të çështjeve gjyqësore”, si dhe u përcaktuan hapat e mëtejshëm të punës për vijimin e procesit.

Në vijim, në datën 18 qershor 2026, u zhvillua mbledhja e grupit ndërinstitucional të punës për Vlerësimin e Masave për Sigurinë në Sistemin Gjyqësor të Republikës së Shqipërisë, ku u prezantua dhe u diskutua drafti i raportit mbi strategjinë e sigurisë në gjykata. Diskutimet u përqendruan tek nevoja për ndryshime ligjore, përmirësimin e infrastrukturës, mbrojtjen e të dhënave personale të gjyqtarëve dhe familjarëve të tyre, si dhe trajnimin e personelit të sigurisë.

18 QERSHOR 2026



Kryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, z. Ilir Rusi, prezantoi në Komisionin për Çështjet Ligjore dhe Administratën Publike, Raportin mbi Gjendjen e Sistemit Gjyqësor dhe Veprimtarinë e Këshillit të Lartë Gjyqësor për vitin 2025.

Në këtë seancë dëgjimore, Kryetari i KLGJ-së u shoqërua nga anëtarët e Këshillit të Lartë Gjyqësor znj. Irena Plaku dhe z. Albens Tabaku.

Gjatë prezantimit të raportit, z. Rusi paraqiti një panoramë të plotë të veprimtarisë së Këshillit gjatë vitit 2025, duke nënvizuar zhvillimet kryesore, rezultatet e arritura në funksion të forcimit të pavarësisë, efikasitetit dhe transparencës së sistemit gjyqësor, si dhe sfidat që vijojnë të kërkojnë vëmendje institucionale.

Kryetari i KLGJ-së theksoi se, pavarësisht progresit të shënuar në konsolidimin e reformave dhe përmirësimin e treguesve të performancës së sistemit gjyqësor, mbeten ende sfida të rëndësishme që lidhen me nivelin e vakancave në gjykata, raportin gjyqtar/popullsi, menaxhimin e çështjeve të prapambetura dhe kohëzgjatjen e proceseve gjyqësore. Në këtë drejtim, ai nënvizoi se adresimi i këtyre sfidave kërkon vazhdimësinë e angazhimeve institucionale dhe zbatimin e masave të qëndrueshme e afatgjata.

Në vijim, z. Rusi prezantoi prioritetet strategjike të KLGJ-së për periudhën 2026–2028, të cilat përqendrohen në plotësimin progresiv të vakancave në sistemin gjyqësor, avancimin e transformimit digjital të gjykatave, forcimin e mekanizmave për reduktimin e backlog-ut, si dhe rritjen e kapaciteteve institucionale, administrative dhe teknologjike të Këshillit dhe të sistemit gjyqësor në tërësi.

Gjatë seancës dëgjimore, Kryetari i KLGJ-së iu përgjigj interesimit dhe pyetjeve të deputetëve, duke ofruar sqarime mbi çështje që lidhen me funksionimin e sistemit gjyqësor, ecurinë e reformave dhe objektivat e Këshillit për periudhën në vijim.

Këshilli i Lartë Gjyqësor mbetet i angazhuar për të vijuar përpjekjet në funksion të garantimit të një sistemi gjyqësor të pavarur, profesional, efikas dhe të aksesueshëm për qytetarët.

19 QERSHOR 2026



Sot, më 19 qershor 2026, Kryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, z. Ilir Rusi, mori pjesë në Konferencën e Konventës Kombëtare për Integrimin Europian.

Aktiviteti u zhvillua në kuadër të projektit “Ndërtimi i Partneritetit mbi Çështjet Themelore: Fuqizimi i Organizatave të Shoqërisë Civile për Procesin e Anëtarësimit në BE”, me mbështetjen financiare të Bashkimit Europian dhe zbatimin nga Lëvizja Europiane në Shqipëri, në bashkëpunim me Akademinë e Integrimit Europian dhe Negociatave (AIEN), Slovak Foreign Policy Association (SFPA) dhe Qendrën për Transparencë dhe Informim të Lirë (CTFI).

Në fjalën e tij, z. Rusi theksoi se besimi i qytetarëve është themeli i një sistemi drejtësie të pavarur, transparent dhe të përgjegjshëm, duke nënvizuar se forcimi i transparencës, llogaridhënies dhe cilësisë së shërbimeve gjyqësore mbetet një prioritet i rëndësishëm në procesin e integrimit europian.

Kryetari i KLGJ-së vlerësoi bashkëpunimin me Qendrën për Transparencë dhe Informim të Lirë (CTFI) në monitorimin e transparencës dhe llogaridhënies së buxhetit gjyqësor, duke theksuar se ky proces ka kontribuar në evidentimin e përmirësimeve në transparencën financiare, performancën institucionale dhe aksesin e qytetarëve në drejtësi.

Ai theksoi gjithashtu rëndësinë e përdorimit të indikatorëve të CEPEJ-it për matjen e performancës së sistemit gjyqësor, si dhe nevojën për të adresuar sfidat që lidhen me ngarkesën e gjykatave, digjitalizimin e proceseve dhe sigurimin e burimeve të mjaftueshme financiare.

Në përfundim, z. Rusi rikonfirmoi angazhimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor për forcimin e pavarësisë, transparencës dhe llogaridhënies së sistemit gjyqësor, në bashkëpunim me institucionet, shoqërinë civile dhe partnerët ndërkombëtarë.

22 QERSHOR 2026



Sot, më 22 qershor 2026, në mjediset e Këshillit të Lartë Gjyqësor, u zhvillua trajnimi me temë "Kuadri ligjor për mbrojtjen e konsumatorit dhe përafrimi me të drejtën e Bashkimit Evropian. Praktika administrative dhe rishikimi gjyqësor", i organizuar nga Këshilli i Lartë Gjyqësor në bashkëpunim me Qendrën "Konsumatori Shqiptar".

Në sesionin e hapjes përshëndetën pjesëmarrësit, Kryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, z. Ilir Rusi, Zv/Ministrja e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, znj. Tana Kika, si dhe Zv/Ministri i Ekonomisë dhe Inovacionit, z. Enkelejd Musabelliu.

Gjatë trajnimit u trajtuan aspektet kryesore të kuadrit ligjor për mbrojtjen e konsumatorit, procesi i përafrimit të legjislacionit shqiptar me të drejtën e Bashkimit Evropian, si dhe praktikat administrative dhe gjyqësore në zgjidhjen e konflikteve ku përfshihen konsumatorët. Vëmendje e veçantë iu kushtua praktikave të padrejta tregtare, kushteve të padrejta kontraktore, kontratave konsumatore, marrëdhënieve ndërmjet administratës publike dhe gjyqësorit, si dhe padive kolektive për mbrojtjen e interesave të konsumatorëve.

Aktiviteti u zhvillua edhe në kuadër të angazhimeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor për garantimin e zhvillimit profesional të magjistratëve dhe forcimin e kapaciteteve të sistemit gjyqësor në trajtimin e çështjeve që lidhen me mbrojtjen e konsumatorit.

23 QERSHOR 2026



Sot, më 23 qershor, 2026 Kryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, z. Ilir Rusi, mori pjesë në Takimin e Koordinimit të Partnerëve, organizuar nga Ministria e Drejtësisë.

Takimi mblodhi përfaqësues të institucioneve të sistemit të drejtësisë, partnerë ndërkombëtarë, donatorë dhe organizata që mbështesin sektorin e drejtësisë në Shqipëri, me synimin për të forcuar koordinimin ndërinstitucional dhe për të harmonizuar mbështetjen ndaj prioriteteve të reformës në drejtësi dhe procesit të integrimit evropian të vendit.

Gjatë aktivitetit, përfaqësuesit e Ministrisë së Drejtësisë prezantuan një analizë të prioriteteve, projektet në zbatim, sfidat e identifikuara, boshllëqet ekzistuese, si dhe prioritetet e programimit për periudhën në vijim. Prezantimi ofroi një panoramë të qartë të nevojave dhe objektivave strategjikë të sektorit të drejtësisë, duke krijuar hapësirë për diskutim dhe koordinim më të mirë mes institucioneve dhe partnerëve mbështetës.

Në fjalën e tij, Kryetari i KLGJ-së vlerësoi rëndësinë e koordinimit të vazhdueshëm ndërmjet institucioneve të sistemit të drejtësisë dhe partnerëve ndërkombëtarë, si një element thelbësor për avancimin e reformave dhe forcimin e kapaciteteve institucionale. Ai theksoi se mbështetja e partnerëve mbetet e rëndësishme për modernizimin e sistemit gjyqësor dhe përmbushjen e standardeve evropiane.

Duke u ndalur te prioritetet, z. Rusi vuri në dukje nevojën për mbështetje të mëtejshme të iniciativave që lidhen me infrastrukturën fizike, infrastrukturën teknologjike, infrastrukturën e burimeve njerëzore dhe nevojën për ndryshime ligjore, të cilat synojnë rritjen e eficiencës, funksionalitetit dhe pavarësisë së sistemit gjyqësor.

Në përfundim të takimit, pjesëmarrësit riafirmuan rëndësinë e dialogut të vazhdueshëm dhe koordinimit efektiv ndërinstitucional, me qëllim garantimin e një mbështetjeje sa më të mirë ndaj prioriteteve të sektorit të drejtësisë dhe procesit të integrimit evropian të Shqipërisë.

26 QERSHOR 2026

Në funksion të përmbushjes së synimeve dhe objektivave strategjikë të Këshillit të Lartë Gjyqësor, gjatë kësaj jave në mjediset e institucionit u zhvilluan takimet e radhës të disa prej grupeve të punës që funksionojnë aktualisht brenda Këshillit.



Në datën 23 qershor 2026, u zhvillua mbledhja e grupit ndërinstitucional të punës Për Vlerësimin e Masave për Sigurinë në Sistemin Gjyqësor të Republikës së Shqipërisë. Në këtë mbledhje u diskutua mbi strategjinë e sigurisë në gjykata, e cila pritet të shoqërohet me një plan veprimi dhe synon unifikimin e rregullave të sigurisë në këto institucione.



Gjithashtu, në datën 23 qershor 2026, u zhvillua mbledhja e radhës e grupit të punës Për Hartimin e Rregullave të Eficiencës për Gjykatat. Në këtë mbledhje u shqyrtua nen për nen draft-udhëzuesi "Për menaxhimin, monitorimin dhe kontrollin e kohëzgjatjes së pezullimit të çështjeve gjyqësore".



Në vijim, në datën 26 qershor 2026, u mblodh grupi i punës Për Rishikimin e Numrit të Përgjithshëm të Gjyqtarëve. Gjatë këtij takimi u prezantuan rezultatet kryesore të metodologjisë për rishikimin e numrit të gjyqtarëve.

Këshilli i Lartë Gjyqësor mbetet i angazhuar për të çuar përpara proceset e rëndësishme të punës, duke konsoliduar më tej masat dhe nismat që mbështesin funksionimin efektiv të sistemit gjyqësor.

29 QERSHOR 2026

Kryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, z. Ilir Rusi, mori pjesë në Konferencën Kombëtare me temë "Ndërveprimi i Drejtësisë me Median. Sfidat Bashkëkohore", të organizuar nga Shkolla e Magjistraturës, si dhe në ceremoninë e diplomimit të kandidatëve për magjistratë të brezit 2023–2026.



Në konferencë morën pjesë drejtues të institucioneve të drejtësisë, përfaqësues të institucioneve shtetërore, partnerë ndërkombëtarë, magjistratë, akademikë, përfaqësues të medias dhe kandidatët për magjistratë.

Gjatë Panelit II, kushtuar strategjive të komunikimit institucional me publikun dhe median, Kryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor z. Ilir Rusi theksoi se transparenca dhe komunikimi institucional përbëjnë elemente thelbësore të administrimit modern të drejtësisë dhe luajnë një rol të rëndësishëm në forcimin e besimit të publikut ndaj sistemit gjyqësor. Ai nënvizoi se pavarësia e gjyqësorit dhe transparenca nuk janë koncepte që përjashtojnë njëra-tjetrën, por parime që duhet të bashkëjetojnë në një shtet të së drejtës, duke garantuar njëkohësisht të drejtën e publikut për informim dhe integritetin e procesit gjyqësor.

Kryetari i KLGJ-së vuri në dukje gjithashtu rëndësinë e komunikimit proaktiv të institucioneve gjyqësore, veçanërisht në çështjet me interes të lartë publik, si dhe nevojën për përdorimin efektiv të platformave digjitale dhe zhvillimin e marrëdhënieve profesionale e të përgjegjshme me median, në funksion të një informimi të saktë dhe në kohë të qytetarëve.

Në vijim të aktivitetit, u zhvillua ceremonia e diplomimit të kandidatëve për magjistratë të brezit 2023–2026.

Në fjalën e tij përshëndetëse për këtë rast, Kryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor përgëzoi magjistratët e rinj për përfundimin me sukses të studimeve dhe vlerësoi përkushtimin e tyre për t'iu bashkuar sistemit të drejtësisë në një periudhë kur pritshmëritë e qytetarëve ndaj institucioneve janë gjithnjë e më të larta.

Ai theksoi se ushtrimi i funksionit të magjistratit kërkon jo vetëm dije profesionale, por edhe integritet, paanësi, kurajë dhe përgjegjësi të lartë publike. Kryetari i KLGJ-së i ftoi magjistratët e rinj të ruajnë gjithmonë besnikërinë ndaj ligjit, të kultivojnë vazhdimisht formimin e tyre profesional dhe të ushtrojnë detyrën me ndershmëri, përulësi dhe përkushtim në shërbim të qytetarëve.

Në përfundim, ai shprehu bindjen se brezi i ri i magjistratëve do të kontribuojë në forcimin e besimit të publikut te drejtësia, përmes profesionalizmit, integritetit dhe respektimit të standardeve më të larta etike.

MASAT E MARRA PËR FUNKSIONALITETIN E SISTEMIT GJYQËSOR

- Këshilli vendosi për një ndryshim në vendimin nr. 263, datë 21.11.2019 "Për miratimin e rregullave plotësuese të vlerësimit të gjyqtarëve.

- Këshilli miratoi vendimin për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 426, datë 14.10.2022 të Këshillit të Lartë Gjyqësor, "Për miratimin e listave tip dhe afatet e ruajtjes së dokumenteve gjyqësore që arkivohen në gjykata", i ndryshuar.

- Këshilli vendosi për miratimin e rregullave mbi menaxhimin e infrastrukturës dhe sistemeve të teknologjisë së informacionit në gjykatat e Republikës së Shqipërisë.

- Gjithashtu, Këshilli miratoi vendimin "Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 78, datë 30.05.2019 të Këshillit të Lartë Gjyqësor, "Për kalendarin e shqyrtimit të çështjeve në gjykatën e apelit", të ndryshuar.

- Këshilli vendosi miratimin e Udhëzimit "Për referimin e ndërmjetësimit nga gjykata".

- Këshilli vendosi për ndryshimin e vendimit nr. 136, datë 29.03.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor "Për fillimin e funksionimit të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër.

- Në përmbushje të detyrimit ligjor, Këshilli i Lartë Gjyqësor vendosi miratimin e "Raport mbi gjendjen e sistemit gjyqësor dhe veprimtarinë e Këshillit të Lartë Gjyqësor për vitin 2025".

- Këshilli vendosi miratimin e "Raportit periodik 3-mujor mbi ecurinë e zbatimit të Udhërrëfyesit për Efikasitetin e Pushtetit Gjyqësor në Shqipëri 2025–2027, për periudhën janar-mars 2026".

- Këshilli vendosi për fillimin e procedurës së vlerësimit etik dhe profesional me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit (gradimin) e gjyqtares znj. Vjollca Spahiu që ka kaluar me sukses procesin e rivlerësimit.

- Këshilli vendosi për fillimin e procedurës së përshpejtuar me kërkesë të vlerësimit etik dhe profesional periudha e vlerësimit viti kalendarik 2025, për gjyqtaren znj. Blerona Hasa.

- Në kuadër të procesit të vlerësimit etiko-profesional të gjyqtarëve si dhe atij të ngritjes në detyrë, Këshilli gjatë 3 mujorit të dytë 2026 vendosi miratimin e raporteve të vlerësimit etik dhe profesional, për 2 gjyqtarë për periudhën 2013-2016, për 2 gjyqtarë për periudhën 2017-2019 dhe për 2 gjyqtarë për periudhën 2020- 2022.

- Këshilli miratoi vendimin për njoftimin e pozicioneve të lira në nivel apeli, për anëtarët e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, që kanë të drejtën e emërimit në një pozicion të tillë. Në vijim të kësaj procedure, Këshilli miratoi vendimet për emërimin dhe caktimin gjyqtar në nivel apeli, për:

  - z. Sokol Çomo pranë Gjykatës Administrative të Apelit;
  - znj. Ina Rama pranë Gjykatës Administrative të Apelit;

- znj. Albana Shtylla pranë Gjykatës Administrative të Apelit;
- znj.Natasha Mulaj pranë Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Juridiksionit të Përgjithshëm;
- znj. Mimoza Tasi pranë Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Juridiksionit të Përgjithshëm.

- Këshilli vendosi për fillimin e procedurës së verifikimit të kritereve ligjore të kandidimit për ngritjen në detyrën e kryetarit në gjykatat e shkallëve të para dhe të dyta.

- Këshilli vendosi kualifikimin dhe vijimin e procedurave të ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm për 10 kandidatë dhe në Gjykatën Administrative të Apelit për 1 kandidat.

- Këshilli miratoi vendimet për renditjen e kandidatëve në procedurën e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për 1 pozicion.

- Këshilli vendosi për verifikimin e plotësimit të tre kritereve të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Lartë për pozicionin e lirë, në fushën e të drejtës administrative, të shpallur me vendimin nr. 5, datë 09.01.2026, të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe vijimin e procedurës së verifikimit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit për 2 kandidatë.

- Këshilli miratoi vendimet për kualifikimin dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë për 14 kandidatë dhe në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës për 26 kandidatë.

- Këshilli ka miratuar vendimet përkatëse për renditjen e kandidatëve në procedurat e lëvizjes paralele:
  - 1 pozicion në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë;
  - 1 pozicion në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë;
  - 1 pozicion në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë.

- Këshilli vendosi fillimin e procedurës së verifikimit të kritereve ligjore të kandidimit në procedurat e lëvizjeve paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë të shpallur me vendimin nr. 830, datë 04.12.2025 të Këshillit të Lartë Gjyqësor, për kandidatët që nuk kanë dhe nuk mund të kenë asnjë vlerësim.

- Këshilli miratoi vendimet për transferimin e gjyqtarëve në procedurën e lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit Vlorë znj. Edona Vajushi znj. Besmira Arshiaj dhe në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë znj. Gentiana Xhelili.

- Këshilli vendosi fillimin e procedurës të përzgjedhjes të kandidatëve për lëvizje paralele në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, të shpallur me vendimin nr. 242, datë 02.05.2024.

- Këshilli vendosi për hapjen e procedurës dhe shpalljen e kërkesës për kandidatura nga radhët e gjyqtarëve për komandim në Këshillin e Lartë Gjyqësor për 2 pozicione.

- Gjithashtu, Këshilli miratoi vendimin për hapjen e procedurës dhe shpalljen e kërkesës për kandidatura nga radhët e gjyqtarëve për komandimin në pozicionin e ndihmësmagjistratit në Gjykatën e Lartë, për 4 pozicione.

- Këshilli vendosi për hapjen e procedurës së komandimit në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë dhe shpalljen e kërkesës për kandidatura nga radhët e gjyqtarëve, për 5 pozicione dhe këto pozicione u rihapën sërish.

- Këshilli vendosi për miratimin e listave emërore të kandidatëve që plotësojnë kriteret për të marrë pjesë në provimin e pranimit në programin e formimit fillestar pranë Shkollës së Magjistraturës, për vitin akademik 2026-2027, për ndihmës ligjor.

- Këshilli miratoi vendimet për përsëritjen e komandimit të gjyqtares znj. Entela Gjoni në pozicionin e “Nëpunës përgjegjës për vlerësimin” në Njësinë e Vlerësimit Profesional dhe Etik të Gjyqtarëve, në Këshillin e Lartë Gjyqësor” si dhe përfundimin e kohëzgjatjes së komandimit të gjyqtares znj. Maela Alicanaj në pozicionin e këshilltarit ligjor në Njësinë e Këshilltarëve të Komisioneve të Përhershme në Këshillin e Lartë Gjyqësor.

- Këshilli vendosi për fillimin e procedurës së verifikimit të kandidatëve për në formimin fillestar për magjistrat, profili gjyqtar, në Shkollën e Magjistraturës, për vitin akademik 2026-2027.

- Këshilli vendosi për fillimin e procedurës së verifikimit të kandidatëve fitues në provimin e pranimit në programin e formimit fillestar në Shkollën e Magjistraturës, për ndihmës ligjorë, viti akademik 2026-2027.

- Më tej, Këshilli miratoi vendimet përkatëse për pranimin në shërbimin civil gjyqësor për znj. Albana Palaj dhe z. Ervin Aliu dhe caktimin e tyre në pozicionin e ndihmësit ligjor në Njësinë e Shërbimit Ligjor pranë Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm.

- Këshilli vendosi për refuzimin e kërkesave së z. Florian Ballhysa dhe znj. Irena Nino për caktimin në pozicionin gjyqtar në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm.

- Më tej, Këshilli vendosi për caktimin e një anëtari në Bordin Drejtues të Qendrës së Teknologjisë së Informacionit për sistemin e drejtësisë.

- Këshilli miratoi listën përfundimtare të gjyqtarëve që do të marrin pjesë në hedhjen e shortit për plotësimin e vendit vakant në Kolegjin Zgjedhor Gjyqësor, i cili u hodh më datë 19.05.2026 në ambientet e Këshillit, ora 11:00 në prani të përfaqësuesve të partive politike, mediave dhe publikut.


- Pas kësaj procedure, Këshilli i Lartë Gjyqësor, në mbledhjen e radhës plenare me vendimin nr. 249, datë 20.05.2026, miratoi zgjedhjen e anëtares të Kolegjit Zgjedhor Gjyqësor znj. Mariana Shegani.

DISIPLINA DHE TRANSPARENCA



KLGJ, në zbatim të ligjit për të drejtën e informimit, gjatë kësaj periudhe, ka trajtuar 3 kërkesa për informacion, të ardhura si përmes postës elektronike ashtu edhe në rrugë zyrtare, të cilat morën përgjigje brenda një afati të arsyeshëm.

Drejtoria e Marrëdhënieve me Publikun, Median dhe Botimet ka trajtuar 218 shkresa të cilat janë paraqitur nga qytetarë, organizata dhe institucione publike dhe jopublike.



- 15 mbledhje plenare
- 128 akte të miratura në ndihmë të të gjithë sistemit gjyqësor, më konkretisht:
  - 2 akte kolektive, Prill 2026
  - 8 akte kolektive, Maj 2026
  - 3 akte kolektive, Qershor 2026
  - 49 akte individuale, Prill 2026
  - 23 akte indviduale, Maj 2026
  - 15 akte individuale, Qershor 2026

Pjesa tjetër përfshihen 21 rregulla të brendshme 5 akte nënligjore dhe 2 të tjera.

-na ndiqni-

KLGJ FACEBOOK

Ndjekës në total

3.8K

Adresa: Godina "Poli i Drejtësisë", Rruga"Ana Komnena", Tiranë
www.klgj.al
e-mail: kontakt@klgj.al